



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Zyra e Kryetarit  
Nr. 01/\_\_\_\_  
Datë : 25.03.2015

Në bazë të nenit 3, paragrafi 1.4 dhe nenit 8 pika (4) të Ligjit Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.35/ datë: 17 dhjetor 2012), për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 2 paragrafi 4, pika (4.2), neni 12 , 13, 14 dhe 15, të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, e në zbatim të vendimit paraprak të kuvendit të komunës Nr. 02/56, dt.02.03.2015, për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës ( paluajtshme ) publike të komunës, si dhe në pajtim me dispozitat e vendimit të kuvendit të komunës së Malishevës nr.02/283 dt.29.07.2014, për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të paluajtshme të komunës, komisioni vlerësues, në mbledhjen e mbajtur me datën 25.03.2015, shpallë:

## **K O N K U R S P U B L I K**

### **Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme publike (tokës) komunale**

**I.** IPET në shfrytëzim afatgjatë, (kohëzgjatja do të përcaktohet me marrëveshje me investitorët e mundshëm, ndërsa do të vendoset me vendim përfundimtar nga kuvendi i komunës), prona e paluajtshme (toka) komunale, në sipërfaqe prej **1.20,00 /ha, pjesa e parcelës kadastrale: P-7231-0025-00299-0**, me kulturë kullosë e klasit të 3-të në vendin e quajtur, “ Palanka-Arat e Borij”,zona kadastrale Dragobil pronë publike në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

**II.** Destinimi i tokës, e cila është objekt i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, është Investimi në kapacitete prodhuese të kapitalit privat, e që do të ndikon në zhvillimin ekonomik të komunës së Malishevës.

#### **Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës:**

- Interesi publik i Komunës,
- Prona e paluajtshme, nuk është në kontest pronësor,
- Është e lirë nga obligimet ndaj personave të tretë,
- Është në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal,
- I plotëson kriteret e përcaktuara mjedisore,
- I plotëson kushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik,
- Ndikon në rritjen e vlerës së pronës.

**Kriteret për vlerësimin e ofertave :**

- Oferta ekonomikisht më e favorshme,
- Vlera e investimit,
- Numri i të punësuarve nga investimi,
- Lloji i investimit,
- Përfitimi financiar i komunës.

**III.** Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës, si dhe personat fizik dhe juridik të regjistruar edhe jashtë Republikës së Kosovës, por që veprimtarinë e tyre e kanë të regjistruar edhe në Republikën e Kosovës).

**IV.** Konkursi Publik do jetë i hapur 45 ditë:

Nga data, 25.03.2015 (dita e shpalljes në web-faqen e komunës së Malishevës, tabelën e shpalljeve të komunës së Malishevës dhe gazetën ditore), dhe i njëjti do të jetë i hapur, deri më datë, 11.05.2015 ora 12:00.

**V.** Tërheqja e aplikacioneve - kopje fizike mund të bëhet në QSHQ (Qendra për Shërbimin e Qytetarëve) në hyrje të objektit të ri Komunës, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri 15:00.

**VI.** Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:  
web – faqes së komunës së Malishevës : <http://kk.rks-gov.net> tel. +381 (029)269-008 , dhe  
e-mail adresës: [komuna.malisheve@rks-gov.net](mailto:komuna.malisheve@rks-gov.net).

**VII.** Personat e interesuar, mund ta shohin pronën, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 15:00 (me personel të autorizuar nga Komuna e Malishevës).

**VIII.** Hapja publike e ofertave bëhet me datë, 11.05.2015, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit të komunës së Malishevës

**IX.** Tërheqja e aplikacioneve sipas konkursit, mund të bëhet jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

*Komisioni Vlerësues:*  
Kryetari i Komisionit për vlerësim  
Ramadan Buzhala

---